



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 375, datë 30.09.2020

MBI
DËRGIMIN E EMRAVE TË KANDIDATËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR T’U
KOMANDUAR NË POZICIONIN E NDIHMËSMAGJISTRATIT PRANË GJYKATËS
SË LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 258, datë 23.07.2020, “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Dërgimin Gjykatës së Lartë, të emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre, si më poshtë:
 - 1) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
 - 2) Znj. {...}gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
 - 3) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
 - 4) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Një kopje e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR